



VENDIM
Nr. 96 Datë 07.12.2010

PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE
TË PRODHUAR NGA TEC VLORE SH.A TEK FURNIZUESI PUBLIK
ME SHUMICË PËR PERIUDHËN 1 JANAR - 31 DHJETOR 2011

Në mbështetje të neneve 9, 26 pika 1, 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 15, 20 dhe 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.21, datë 18.03.2009, Vendimit Nr.77, datë 26.06.2008, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2010, pasi shqyrtoi aplikimin e TEC Vlora sh.a si dhe relacionin e Grupit të Punes,

Vendosi :

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike së prodhuar nga TEC Vlora Sh.a tek Furnizuesi Publik me shumicë, për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2011 do të jete kosto fikse vjetore **1,341,482 mijë lekë/vit** dhe kosto variabël **16 leke/kWh**.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e TEC VLORE sh.a. dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

